



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.17 dhe Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 2 paragrafi 3.4 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
- Kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të datës 05 dhjetor 2012;

**në seancën e mbajtur më 28 dhjetor 2012 nxori këtë:**

## VENDIM

- I. **I lejohet** KOSTT SH.A. derogimi në zbatimin e disa dispozitave të Neneve të **Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit**, si në shtojcë të këtij vendimi.
- II. **I Lejohet** KOSTT SH.A. derogimi i Nenit 25 “Obligimi i Sigurimit” të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit deri më datë **31.12.2013**.

## ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 05 dhjetor 2012 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të Sistemit të Transmisionit, ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejojë derogimin në zbatimin e dispozitave të neneve të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit në afatet e vendosura si në Shtojcë të këtij vendimi.
  - ZRRE ka lejuar derogim të Nenit 25 të Licencës së OSSH-së, si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi edhe pse nuk ka qenë pjesë e kërkesës së KOSTT SH.A për derogim. Kjo lidhet me Vendimin e Bordit Nr. D\_114\_2008 i nxjerrë me datë 15.08.2008 që ka të bëjë me derogimin në zbatimin e Nenit 24 “**Obligimi i Sigurimit**” të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit (licenca e vjetër), që ishte në afat të pacaktuar, tani Neni 25 (“**Obligimi i Sigurimit**”) i Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit.
  - Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

*\*Bashkangjitur dokumenti me dispozitat për të cilat është lejuar derogimi.*

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

## **Raporti i Derrogimeve\_Kodi i Rrjetit dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit**

**Dhjetor 2012**



Nr.	Kodi i Rrjetit	Neni	Paragrafi	Periudha e Derogimit e kërkuar (në vite/muaj)	Periudha deri kur vlen Derogimi	Arsyeja e Kërkesës për Derogim
1	Kodi i Planifikimit	4. Standardet dhe Kriteret e Planifikimit të Transmisionit	4.1.1.2	1. 2 vite 2. 2 vite 3. 2 vite 4. 2 vite 5. <b>3 vite</b>	01.11.2011 31.12.2010 31.12.2011 <b>31.12.2012</b> <b>31.12.2013</b>	Bazuar në Planin Zhvillimor të Transmisionit Kriteri (N-1) nuk mund të plotësohet edhe më tutje në këto pjesë të sistemit të transmisionit si më poshtë: - ATR në NS Peja 3 (për 400 orët vjetore nuk plotësohet). - Linja 110 kV nr 1809 NS Prizreni 2 – NS Rahovec, e cila ndërlidhet me paket projektin Malisheva.
2	Kodi i Planifikimit Operativ	3.8 Kërkesat për Rezervat	3.8.1.1	1. 3 vite 2. 1 vit 3. 1 vit 4. 1 vit 5. 1 vit 6. <b>2 vite</b>	27.08. 2010 30.06.2011 31.12.2011 30.06.2012 <b>31.12.2012</b> <b>31.12.2013</b>	Në mungesë të njësive rregulluese nuk implementohet kjo dispozitë derisa të ketë Marrëveshje të KOSTT-it dhe kompanive të shteteve fqinje për rezervë rrotulluese.



			3.8.1.2			Rregullimi sekondar momentalisht bëhet nga EMS sipas një marrëveshje teknike. KOSTT në janar 2010 ka nënshkruar Marrëveshjen e Shërbimeve Ndhmëse me KEK Gjenerimin TC Kosova B, implementimi i së cilës do të filloj me krijimin e kushteve, kurse MSHN KOSTT - KESH është nënshkruar në mars 2010, e cila do të implementohet pasi të sigurohet infrastruktura e nevojshme teknike si dhe definimi final i mënyrës së operimit me këto shërbime ndihmëse
		<b>4.4.6 Ofertat dhe Propozimet</b>	4.4.6.1	1. 3 vite 2. 3 vite 3. 1 vit 4. 1 vit	01.11.2010 31.12.2011 30.06.2012 <b>31.12.2012</b> <b>31.12.2013</b>	Gjatë periudhës tranzitore të implementimit të Rregullave të Tregut Ofertat dhe Propozimet nuk do të aplikohen. Pasi nuk kemi ende treg balancues, nuk kemi oferta e as propozime.
			4.4.6.3	<b>5. 1 vit</b>		
3	<b>Kodi i Balancit</b>	<b>2.4.4 Aranzhmanet Balancuese</b>	2.4.4.1	1. 3 vite 2. 2 vite 3. 2 vite 4. 1 vit <b>5. 1 vit</b>	01.11.2010 31.12.2011 30.06.2012 <b>31.12.2012</b> <b>31.12.2013</b>	Aktualisht KOSTT është në fazën e finalizimit të modifikimit të Rregullave të Tregut të energjisë elektrike, ku është paraparë edhe mekanizmi balancues. Deri në aprovimin dhe funksionimin e Rregullave të Tregut, KOSTT do të bëj



			2.4.4.2			përpjekje për balancimin e sistemit duke përdorur prodhimin në disponim, importet dhe shkyqjet sipas planit të reduktimeve ABC.
		<b>3.9 Programi i Tensionit</b>	3.9.1.3	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 6 muaj</li> <li>2. 1 vit</li> <li>3. 1 vit</li> <li>4. 1 vit</li> <li>5. 1 vit</li> <li>6. 1 vit</li> <li>7. <b>2 vite</b></li> </ol>	<p>01.05.2008</p> <p>01.11.2008</p> <p>01.11.2009</p> <p>31.12.2010</p> <p>31.12.2011</p> <p><b>31.12.2012</b></p> <p><b>31.12.2013</b></p>	Karaktersistikat e njësive gjeneruese aktuale nuk mundësojnë implementimin e kësaj pike
		<b>4.4.5 Rregullimi Kohor</b>	4.4.5.1	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 1 vit</li> <li>2. 1 vit</li> <li>3. 1 vit</li> <li>4. <b>2 vite</b></li> </ol>	<p>31.12.2010</p> <p>31.12.2011</p> <p>31.12.2012</p> <p><b>31.12.2013</b></p>	Derisa mos të bëhemi anëtarë të plotë të ENTSO-E nuk mund ta plotësojmë këtë obligim.
			4.4.5.2			



4	Kodi Operativ	5.5.3 Stabiliteti dhe Mbningarkesa e Rrjetit	5.5.3.2	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 1 vit</li> <li>2. 1 vit</li> <li>3. 3 vite</li> <li>4. 2 vite</li> <li>5. 2 vite</li> <li>6. <b>3 vite</b></li> </ol>	<p>01.11.2008</p> <p>01.11.2009</p> <p>31.12.2010</p> <p>31.12.2011</p> <p><b>31.12.2012</b></p> <p><b>31.12.2013</b></p>	<p>Pika e tretë e këtij neni Kriteri N-1 nuk plotësohet për elementet e sistemit të cekura si për nenin 4.1.1.2 të Kodit të Planifikimit.</p>
		5.5.5 Reduktimi nga nënfrekuenca	5.5.5.1	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 6 muaj</li> <li>2. 6 muaj</li> <li>3. 1 vit</li> <li>4. <b>2 vite</b></li> </ol>	<p>31.12.2011</p> <p>30.06.2012</p> <p><b>31.12.2012</b></p> <p><b>31.12.2013</b></p>	<p>Pas vendimit të Qeverisë për ndryshimin e kufirit përkatësisht kalimin e disa aseteve nga KEK-u në KOSTT, është bërë analiza e re për vendosjen e mbrojtjes nënfrekuenete në anën sekondare të Transformatorëve. Tani jemi në fazën e identifikimit të fushave të Transformatorëve që kanë mbrojtje rele me funksionin e mbrojtjes nënfrekuenete. Në bazë të verifikimit nga terreni rezulton që nga 49 fusha të transformatorëve 44% e kanë mbrojtjen nënfrekuenete dhe 56% nuk e kanë këtë funksion. Në fushat ku e kemi këtë funksion do ta veme në funksion sapo të krijohen kushtet për ndërrimin e parametrave dhe testimin e tyre gjatë vitit 2013. Kurse për fushat e transformatorëve që nuk e kanë këtë funksion do të bëhet me investime në vitet e ardhshme.</p>



<p><b>5.8.11 Testimi i Startimit nga Errësira</b></p>	<p>5.8.11</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 2 vite</li> <li>2. 1 vit</li> <li>3. 1 vit</li> <li>4. 6 muaj</li> <li>5. 1 vit</li> <li>6. <b>2 vite</b></li> </ol>	<p>01.11.2009 31.12.2010 30.06.2011 31.12.2011 <b>31.12.2012</b> <b>31.12.2013</b></p>	<p>Duke u bazuar në faktin se KOSTT duhet të ket marëveshje interkonektive me OST-të tjera për realizim të simulimit të startimit nga zero, me ç'rast furnizimi i konsumit vendor duhet të sigurohet në kohëzgjatje së paku disa orëshe, nga shkakut se nuk mund të sigurohet puna në "ilotazhë" e njëjësive gjeneruese të KEK-ut, kjo aktualisht nuk është e mundur, nga fakti se menaxhimin e kapaciteteve interkonektive ende nuk e kryen KOSTT-i, me çka nënkuptohet mbetje pa furnizim e konsumit vendor në kohën deri sa mos të kthehen njësitë gjeneruese vendore në operim normal, që do kishte për pasojë kosto të lartë financiare, dhe pamundësi të justifikimit të një veprimi të tillë aktualisht.</p>
<p><b>8 Testimet e Sistemit</b></p>	<p>8.4.1.2</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. 1 vit</li> <li>2. 1 vit</li> <li>3. 16 muaj</li> <li>4. 2 vite</li> <li>5. 1 vit</li> <li>6. 1 vit</li> <li>7. <b>1 vit</b></li> </ol>	<p>27.08.2009 27.02.2010 31.12.2010 30.06.2011 31.12.2011 <b>31.12.2012</b> <b>31.12.2013</b></p>	<p>KOSTT konsideron se në rrethanat aktuale të SEE të Kosovës, nuk ekziston mundësia për testimet e cekura në pikën e dytë dhe katërt të kësaj dispozite.</p>





Nr.	Licenca	Neni	Paragrafi	Periudha e Derogimit e kërkuar (në vite/muaj)	Periudha deri kur vlen Derogimi	Arsyeja e Kërkesës për Derogim
	Licenca e OST	10. Dsponueshmëria dhe Mirëmbajtja e të Dhënave	10.3	1. 1 vit 2. 6 muaj 3. 1 vit 4. 1 vit 5. 1 vit 6. 1 vit 7. 1 vit 8. 1 vit 9. 1 vit <b>10. 1 vit</b>	24.11.2008 24.06.2009 24.11.2009 30.06.2010 31.12.2010 30.06.2011 31.12.2011 30.06.2012 <b>31.12.2012</b> <b>31.12.2013</b>	Mirëmbajtja e të dhënave të informacioneve për kapacitetet ndërkufitare bëhet por publikimi për kapacitetet ndërkufitare, funksionimin e interkonektorëve, kongestionit, dispeçimin e kapaciteteve gjeneruese, shfrytëzimin e shërbimeve ndihmëse si dhe funksionimin e tregut balancues Tani disponojmë me harduerin e nevojshëm për kalkulimin e rrjedhave të fuqisë, kurse softueri adekuat duhet të zhvillohet. Të gjitha këto bëhen me softuerin PSSE, por nuk mund të jenë valide pa këmbimin e modeleve të OST-ve fqinje e kjo është si pasojë e mospërfshirjes së KOSTT në Mekanizmat regjional si ITC/CBT dhe anëtarësimi në ENTSO-E si dhe veprimet e paligjshme dhe të pa autorizuara të EMS-it në alokimin e kapaciteteve interkonektive të KOSTT.



		<b>12. Operimi i Sistemit</b>	<b>12.1 12.2 (2.4 dhe 2.8)</b>	1. 1 vit 24.11.2008 2. 1 vit 24.11.2009 3. 2 vite 30.06.2010 4. 13 muaj 31.12.2010 5. 2 vite 31.12.2011 6. 1 vit 30.06.2012 7. 1 vit <b>31.12.2012</b> 8. <b>1 vit 31.12.2013</b>	Sipas rrethanave aktuale KOSTT nuk i menaxhon kapacitetet e interkonekcionit dhe nuk mund të parashihen importet dhe eksportet në linjat interkonektive (pika 2.4). Për shkak se mekanizmi balancues nuk është i përfshirë në Rregullat e Tregut (transicionale), nuk mund të realizohet pika 2.8 e këtij Neni.
		<b>13 Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndihmëse</b>	<b>13.1 dhe 13.2</b>	1. 3 vite 01.11.2009 2. 2 vite 30.06.2010 3. 2 vite 31.12.2010 4. 2 vite 30.06.2011 5. 2 vite 31.12.2011 6. 1 vit 30.06.2012 7. 1 vit <b>31.12.2012</b> 8. <b>1 vit 31.12.2013</b>	Për shkak të rrethanave aktuale në SEE të Kosovës Rregullimi terciar nuk mund të sigurohet sipas kushteve të parapara me Kodin e Rrjetit si dhe në tarifa nuk mund të mbulohet.